



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 45

3 prill

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 98/2013 datë 18.3.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut për transferimin e personave të dënuar.....	2013
Ligj nr. 99/2013 datë 18.3.2013	Për armët.....	2019
Ligj nr. 100/2013 datë 18.3.2013	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”.....	2035
Ligj nr. 101/2013 datë 18.3.2013	Për një ndryshim në ligjin nr. 8653, datë 31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.....	2036

LIGJ
Nr. 98/2013

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE E IRLANDËS SË
VERIUT PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut për transferimin e personave të dënuar, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.3.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8069, datë 29.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE
**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË BASHKUAR TË
BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT MBI TRANSFERIMIN E PERSONAVE
TË DËNUAR**

Republika Shqipërisë (më poshtë referuar si “Shqipëria”) dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (më poshtë referuar si “Mbretëria e Bashkuar”), së bashku Palët,

duke marrë në konsideratë zhvillimet në marrëveshjet ndërkombëtare të transferimit të të dënuarëve;

me dëshirën për të siguruar që sa herë të jetë e mundur të dënuarit shtetas të huaj të vuajnë dënimin e tyre në vendin e vet;

duke afirmuar respektimin e të drejtave të njeriut, gjatë trajtimit të personave të dënuar, kanë rënë dakord si më poshtë:



Neni 1 **Përkufizime**

Për qëllime të kësaj marrëveshjeje:

- a) “Shteti transferues” nënkupton shtetin nga i cili personi i dënuar mund të transferohet ose është transferuar.
- b) “Shteti marrës” nënkupton shtetin në të cilin personi i dënuar mund të transferohet ose është transferuar.
- c) “Person i dënuar” nënkupton një person, i cili kërkohet të mbahet nën arrest në burg ose në çdo institucion tjetër të shtetit transferues, në bazë të vendimit të marrë nga gjykata e shtetit transferues për shkak të një vepre penale.
- ç) “Dënim” nënkupton çdo ndëshkim ose masë që përfshin heqjen e lirisë të urdhëruar nga një gjykatë e shtetit transferues për një periudhë kohe të kufizuar ose të pakufizuar për shkak të një vepre penale.
- d) “Vendim” nënkupton një vendim ose urdhër të një gjykate që jep një dënim; dhe
- dh) “Shtetas” nënkupton:
 - i) në lidhje me Shqipërinë, një person i cili ka shtetësinë shqiptare;
 - ii) në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar, një shtetas anglez ose çdo person, transferimin e të cilit Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar e gjykon të përshtatshme, duke pasur parasysh çdo lidhje të ngushtë që ai person mund të ketë me Mbretërinë e Bashkuar.

Neni 2 **Parime të përgjithshme**

1. Palët i ofrojnë njëra-tjetrës nivelin më të gjerë të bashkëpunimit në lidhje me transferimin e personave të dënuar në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.
2. Ndërmjet Palëve, kjo marrëveshje ka përparësi mbi çdo marrëveshje shumëpalëshe që rregullon transferimin e personave të dënuar, në të cilat të dyja Palët janë palë.
3. Kur të dyja Palët bien dakord dhe në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, një person i dënuar mund të transferohet nga territori i shtetit transferues në territorin e shtetit marrës, pa pëlqimin e personit të dënuar, në mënyrë që personi i dënuar të vazhdojë vuajtjen e dënimit të dhënë nga shteti transferues.
4. Transferimi i personave të dënuar mund të kërkohet nga shteti transferues ose shteti marrës.
5. Palët mund të lidhin një memorandum mirëkuptimi që rregullon zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 3 **Kushtet për transferim**

Personat e dënuar mund të transferohen sipas kësaj marrëveshjeje vetëm në kushtet e mëposhtme:

- a) personi i dënuar është një shtetas i shtetit marrës për qëllime të kësaj marrëveshjeje;
- b) personi i dënuar jep pëlqimin për transferimin ose është subjekt i një urdhri për dënim, deportim ose largim nga shteti transferues;
- c) vendimi është përfundimtar dhe asnjë procedim tjetër ligjor që lidhet me veprën ose ndonjë veprë tjetër të kryer nga personi i dënuar nuk është në proces në shtetin transferues;
- d) veprimet ose mosveprimet për të cilat është dhënë dënimi, përbëjnë një veprë penale sipas ligjit të shtetit marrës ose do të përbënin një veprë penale nëse kryhej në territorin e tij;

- e) personi i dënuar ka ende të paktën 6 muaj dënim për të vuajtur në kohën që merret kërkesa për transferim; në raste të veçanta, Palët mund të bien dakord për transferimin edhe nëse personi i dënuar ka më pak se 6 muaj dënim për të vuajtur; dhe
- f) shteti transferues dhe marrës bien dakord për transferimin.

Neni 4

Procedurat për transferim

1. Kërkesat për transferim dhe përgjigjet bëhen me shkrim ndërmjet autoriteteve përkatëse.
2. Nëse shteti marrës kërkon transferimin e personit të dënuar, ai duhet t'i japë informacionin e mëposhtëm, kur është e mundshme, shtetit transferues me kërkesë me shkrim për transferimin:
 - a) emri, data dhe vendi i lindjes së personit të dënuar;
 - b) vendndodhja e personit të dënuar; dhe
 - c) adresa e përhershme e personit të dënuar në shtetin marrës.
3. Nëse shteti transferues kërkon transferimin e një personi të dënuar ose, pas marrjes së një kërkesë për transferim, sipas paragrafit 2 të këtij neni, është i gatshëm në parim, për të shqyrtuar kërkesën për transferim të një personi të dënuar, ai informon shtetin marrës me shkrim dhe i jep informacionin e mëposhtëm:
 - a) emri, data, vendi i lindjes dhe fotografia e personit të dënuar;
 - b) vendndodhja e personit të dënuar;
 - c) nëse është e mundshme, adresa e përhershme e personit të dënuar në shtetin marrës;
 - ç) një deklaratë të fakteve mbi të cilat bazohet dënimi dhe vendimi;
 - d) lloji, kohëzgjatja dhe data e fillimit të dënimit, data e përfundimit të dënimit, sipas rastit dhe gjatësia e kohës së vuajtur tashmë nga personi i dënuar dhe çdo ulje dënimi që i është dhënë personit të dënuar për shkak të punës së bërë, sjelljes së mirë, paraburgimit ose arsye të tjera;
 - dh) një kopje të vendimit dhe informacionit të ligjit mbi të cilën është bazuar;
 - e) sipas rastit, çdo informacion tjetër shtesë, duke përfshirë raportet mjekësore dhe sociale mbi personin e dënuar, të cilat mund të jenë të rëndësishme për transferimin e personit të transferuar dhe për vazhdimin e ekzekutimit të dënimit;
 - ë) një kopje të çdo përfaqësimi të bërë me shkrim nga personi i dënuar në përputhje me paragrafin 4 të nenit 8 të kësaj marrëveshjeje:
 - i) çdo detyrim ose garanci të kërkuar nga shteti transferues në lidhje me vendndodhjen ose burgun, në të cilin personi i dënuar do të vuajë pjesën e mbetur të dënimit; kushtet ose trajtimin që i ofrohet personit të dënuar; procesin për monitorimin e këtyre kushteve dhe trajtimin; çdo çështje tjetër që lidhet me transferimin.
4. Nëse shteti marrës, pasi ka shqyrtuar informacionin e dhënë nga shteti transferues, është i gatshëm të procedojë me transferimin, ai informon shtetin transferues me shkrim dhe siguron informacionin e mëposhtëm:
 - a) një deklaratë që tregon se personi i dënuar është shtetas i ose ka lidhje përkatëse me shtetin marrës për qëllime të kësaj marrëveshjeje;
 - b) një kopje e ligjit përkatës të shtetit marrës, i cili parashikon se veprimet ose mosveprimet për shkak të të cilave është dhënë dënimi në shtetin transferues, përbëjnë një vepër penale sipas ligjit të shtetit marrës ose do të përbënin një vepër penale nëse kryhej në territorin e tij;
 - c) një deklaratë, në lidhje me personin e dënuar, në zbatim të çdo ligji apo rregulloreje që lidhet me ndalimin e atij personi në shtetin marrës, pas transferimit të atij personi, duke përfshirë një deklaratë, nëse është e zbatueshme, sipas paragrafit 2 të nenit 7 të kësaj marrëveshjeje me transferimin e atij personi;



ç) një deklaratë për çdo akuzë, dënim apo hetim penal në proces, në lidhje me personin e dënuar;

d) miratim për çdo detyrim ose garanci siç kërkohet nga shteti transferues, sipas paragrafit 3(i).

5. Nëse shteti transferues është i gatshëm të procedojë me transferimin, ai i siguron shtetit marrës miratimin e tij me shkrim për kushtet e transferimit.

6. Kur Palët kanë rënë dakord për transferimin, ata marrin masa për transferimin e personit të dënuar. Dorëzimi i personit të dënuar nga autoritetet e shtetit transferues tek ato të shtetit marrës, ndodh në një datë dhe në një vend të rënë dakord nga të dyja palët.

7. Nëse secila nga palët vendos që të mos bjerë dakord për transferimin, ajo informon Palën tjetër për vendimin e saj me shkrim.

Neni 5

Efekti i transferimit për shtetin transferues

1. Marrja në dorëzim e personit të dënuar nga autoritetet e shtetit marrës ka efektin e pezullimit të zbatimit të dënimit nga autoritetet në shtetin transferues.

2. Shteti transferues nuk zbaton dënimin, nëse shteti marrës çmon që zbatimi i dënimit të ketë përfunduar.

Neni 6

Ruajtja e juridiksionit

Shteti transferues ruan juridiksion ekskluziv për rishikimin e vendimit gjyqësor dhe të dënimit.

Neni 7

Vazhdimi i zbatimit të dënimit

1. Nëse dënimi i dhënë nga shteti transferues është në pajtim me ligjet e shtetit marrës, shteti marrës e zbaton dënimin, sikur dënimi të ishte dhënë në shtetin marrës. Shteti marrës nuk e konverton dënimin në një dënim që mund të ishte dhënë në shtetin marrës për një vepër penale të ngjashme.

2. Nëse dënimi e kalon dënimin maksimal të parashikuar në shtetin marrës për një vepër penale të ngjashme, shteti marrës, me pëlqimin e shtetit transferues, para transferimit, mund të ulë dënimin në dënimin maksimal të parashikuar në legjislacionin e shtetit marrës për atë vepër penale. Autoritetet përkatëse të shtetit marrës u nënshtrohen konstatimeve faktike, në masën që ato dalin në një mendim, vendim fajësimi, vendim ose dënim të dhënë në shtetin transferues. Vendimi në natyrën ose në kohëzgjatjen e vet nuk e rëndon masën e dënimit të dhënë në shtetin transferues.

3. Vazhdimi i zbatimit të dënimit pas transferimit rregullohet nga ligjet dhe procedurat e shtetit marrës, duke përfshirë ato që rregullojnë kushtet e burgimit, kufizimit ose ndonjë heqje tjetër lirie dhe ato që parashikojnë uljen e periudhës së burgimit, kufizimit ose ndonjë heqje tjetër lirie, me kusht, lirim me kusht, ulje dënimi ose ndryshe.

4. Shteti marrës ndryshon ose pushon zbatimin e dënimit sapo të informohet për ndonjë vendim nga shteti transferues për të falur personin e dënuar ose nga ndonjë vendim, ose masë tjetër e shtetit transferues që rezulton në anulimin ose uljen e dënimit.

5. Shteti marrës i jep informacionin e mëposhtëm shtetit transferues në lidhje me vazhdimin e zbatimit të dënimit:

a) kur dënimi ka përfunduar;

- b) nëse personi i dënuar është arratisur nga burgu përpara përfundimit të dënimit;
- c) nëse personi i dënuar është i paaftë të përfundojë dënimin për ndonjë arsye; ose
- ç) një raport të posaçëm, nëse kërkohet nga shteti transferues, duke përfshirë një raport të posaçëm për ato çështje ku shtetet kanë rënë dakord për garanci ose detyrime të caktuara, në përputhje me paragrafët 3 (i) dhe 4 (e) të nenit 4.

Neni 8

Të drejtat e personave të dënuar

1. Një person i dënuar mund të shprehë ndaj shtetit transferues ose ndaj shtetit marrës, interes për t'u transferuar sipas kësaj marrëveshjeje.
2. Një person i dënuar, transferimi i të cilit kërkohet sipas kësaj marrëveshjeje:
 - a) informohen nga shteti transferues mbi përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje;
 - b) i shpjegohen me shkrim kushtet e transferimit në gjuhën e personit të dënuar;
 - c) i jepet mundësia të bëjë përfaqësime me shkrim pranë autoriteteve të shtetit transferues përpara se shteti transferues të japë pëlqimin e tij me shkrim ndaj kushteve të transferimit, brenda kuptimit të paragrafit 5 të nenit 4.

Neni 9

Trajtimi i personave të dënuar

Çdo palë trajton personat e dënuar të transferuar sipas kësaj marrëveshjeje, në përputhje me detyrimet e zbatueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, veçanërisht në lidhje me të drejtën ndaj jetës dhe ndalimin kundër torturës dhe trajtimit ose dënimit mizor, çnjerëzor ose degradues.

Neni 10

Ndjekja penale për vepra të tjera

1. Një person i dënuar, i transferuar sipas dispozitave të kësaj marrëveshjeje, nuk ndiqet penalisht, dënohet ose ndalohet me qëllim kryerjen e një dënimi ose urdhri ndalimi për ndonjë veprë penale të kryer përpara transferimit, të ndryshme nga ajo për të cilën është vendosur dënimi që duhet të zbatohet; gjithashtu, personave të dënuar nuk do t'u kufizohet liria personale për ndonjë arsye tjetër, përveç rrethanave të mëposhtme:
 - a) kur shteti transferues e autorizon këtë, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni; ose
 - b) kur personi i dënuar, pasi të ketë pasur mundësinë për t'u larguar nga territori i shtetit marrës, nuk e ka bërë këtë brenda 45 ditëve nga përfundimi i dënimit ose nëse personi i dënuar është kthyer në shtetin marrës pasi të jetë larguar prej tij.
2. Sipas nënparagrafit 1(a) të këtij neni, shteti marrës i paraqet një kërkesë për autorizim shtetit transferues. Kërkesa për autorizim shoqërohet nga të gjitha dokumentet përkatëse dhe vërtetim ligjor të ndonjë deklarate të bërë nga personi i dënuar. Autorizimi mund të jepet nga shteti transferues, kur vepra për të cilën kërkohet, do të ishte e ekstradueshme sipas ligjit të shtetit transferues ose kur ekstradimi do të përjashtohej vetëm për shkak të kohëzgjatjes së dënimit.

Neni 11

Transiti i personave të dënuar

Nëse një Palë transferon një person të dënuar për ose nga një shtet i tretë, Pala tjetër do të bashkëpunojë për lehtësimin e transitit të këtij personi të dënuar, nëpërmjet territorit të saj. Pala që synon të bëjë një transferim të tillë, do t'i japë njoftim paraprak palës tjetër në lidhje me këtë transit.



Ky nen nuk cenon të drejtën e ndonjë Pale për të refuzuar dhënien e transitit në një rast të veçantë.

Neni 12

Zbatimi territorial

Kjo marrëveshje zbatohet:

- a) në lidhje me Shqipërinë, për territorin e Republikës së Shqipërisë; dhe
- b) në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar, në territorin e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandën e Veriut dhe Ishulli i Man dhe çdo territor tjetër për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit Mbretëria e Bashkuar është përgjegjëse dhe në të cilin kjo marrëveshje do të jetë shtrirë me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet Palëve me anë të shkëmbimit të notave.

Neni 13

Zbatimi i përkohshëm

Kjo marrëveshje është e zbatueshme për transferimin e personave të dënuar të cilët janë dënuar para ose pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve që lind nga ose në lidhje me këtë marrëveshje do të zgjidhet me anë të rrugëve diplomatike.

Neni 15

Dispozitat përfundimtare

1. Secila prej Palëve njofton tjetrën në lidhje me përfundimin e procedurave të tyre përkatëse të brendshme kushtetuese dhe ligjore të kërkuara për të mundësuar hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të fundit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Secila Palë mund të përfundojë këtë marrëveshje në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjetër. Ky përfundim do të hyjë në fuqi me mbarimin e një periudhe gjashtëmujore pas datës së marrjes së njoftimit.

4. Pavarësisht nga ndonjë përfundim, kjo marrëveshje dhe çdo garanci ose detyrim i dhënë sipas saj, do të vazhdojë të aplikohet për zbatimin e dënimeve të personave të dënuar të cilët janë transferuar sipas kësaj marrëveshjeje përpara datës në të cilën ky përfundim hyn në fuqi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullave për këtë nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në Londër, në dy kopje, më 15 janar 2013, në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze, ku secili tekst është njëlloj autentik.

LIGJ
Nr. 99/2013

PËR ARMËT¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e veprimit

1. Ky ligj rregullon kushtet për blerjen, mbajtjen, ruajtjen, prodhimin, riparimin, çaktivizimin, tregtimin, shitjen, gjurmimin, transportimin, importimin e armëve dhe municionit për personat fizikë dhe juridikë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe eksportimin nga Republika e Shqipërisë.

2. Me përjashtim të rasteve kur ky ligj përcakton ndryshe, dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për armatimin ushtarak, pajisjet, armët dhe municionin e dedikuar për nevojat e Forcave të Armatosura dhe të strukturave të tjera të armatosura shtetërore.

3. Nuk përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji veprimtaritë e import-eksportit të armëve dhe municionit të zhvilluara sipas dispozitave të ligjit nr. 9707, datë 5.4.2007 “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, të ndryshuar.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Armë e zjarrit” është çdo armë e transportueshme, me tytë, që realizon, është projektuar për të realizuar ose mund të modifikohet lehtësisht për të realizuar të shtëna, plumba ose predha, me anë të një lënde plasëse.

2. “Armë e shkurtër e zjarrit” është arma e zjarrit me tytë jo më të gjatë se 30 cm apo me gjatësi të përgjithshme të armës jo më shumë se 60 cm.

3. “Armë e gjatë e zjarrit” është arma e zjarrit me tytë më të gjatë se 30 cm apo me gjatësi të përgjithshme të armës më shumë se 60 cm.

4. “Armë automatike e zjarrit” është arma e zjarrit, e cila mbushet automatikisht sa herë që shkrepët fisheku dhe që mund të shkrepë më shumë se një fishek me një tërheqje të këmbëzës.

¹ Ky ligj është përafëruar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 91/477/KEE, datë 18 qershor 1991 “Për kontrollin e blerjeve dhe posedimit të armëve”, e ndryshuar. Numri CELEX: 31991L0477, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 256, datë 13.9.1991, faqe 51-58.



5. “Armë gjysmautomatike e zjarrit” është arma e zjarrit që rimbushet në mënyrë automatike sa herë shkrepet fisheku dhe që mund të shkrepë vetëm një fishek me një tërheqje të këmbëzës.

6. “Armë të drejtuara me energji (ADE)” është lloji i armës që çliron energji në një drejtim të shënjuar, pa përdorur predhën. Kjo armë e bart energjinë të shënjestra për qëllim të efektit të dëshiruar.

7. “Armë me mbushje mekanike e zjarrit” është arma e zjarrit, e cila, pas shkrepjes së plumbit, është e paracaktuar për t’u rimbushur me dorë nga karikatori apo nga cilindri.

8. “Armë zjarri me qitje një nga një” është arma e zjarrit pa karikator, e cila mbushet para çdo shkrepjeje, përmes futjes me dorë të fishekut në fole apo në hapjen për mbushje në të prerën e tytës.

9. “Armë pneumatike” është arma, përmes së cilës shkrepet predha me presion të ajrit apo gazrave të kompresuara, operacion ky i ngjashëm në parim me punën e sistemeve të gypave pneumatikë.

10. “Armë për përdorim të mjeteve të ndryshme” janë të gjitha llojet e pushkëve, pistoletave, revolverëve apo mjeteve të tjera, të cilat, nën shtypjen e barutit ose të gazrave, përhapin në një drejtim gaz ngacmues që ka ndikim në shëndetin e njeriut.

11. “Armë e zjarrit për sinjalizim të lehtë akustik” është arma e zjarrit që zakonisht përdoret si sinjal për ndonjë fatkeqësi, si dhe për qëllime të tjera sinjalizuese në det, duke përfshirë të gjitha llojet e pistoletave, revolverëve dhe mjeteve të tjera, të cilat, nën shtypjen e armës, barutit apo të gazrave, shkrepin apo hedhin të shtëna sinjalizuese në një drejtim dhe lëshojnë predha, me përjashtim të pistoletave ndriçuese për përdorim ushtarak.

12. “Armë shpërthyesë” nënkupton, kryesisht, çdo lloj bombe, mine, rakete, granate apo mjeti tjetër që përmban lëndë plasëse apo materiale ndezëse, ndaj të cilave, për shkak të proceseve të brendshme apo të jashtme (peshës, ndikimit, fërkimit, reagimit kimik, energjisë elektrike dhe të ngjashme) shkaktohet lirimi apo krijimi i energjisë dhe eksplozimit. Në bazë të këtij ligji, armë shpërthyesë, gjithashtu, konsiderohen pjesët e eksplozivëve, detonatorët, mjetet piroteknike apo pjesët e tjera, për të cilat qartazi duket se janë të paracaktuara për përgatitjen e armëve shpërthyesë. Ky përkufizim është i paracaktuar të përfshijë armët termobarike, të cilat dallohen nga armët konvencionale eksplozive, për shkak se funksionojnë me oksigjen atmosferik dhe nuk kanë oksidues në eksplozivët e tyre. Armët termobarike, po ashtu, quhen armë termobarike me impuls të lartë (TIL), eksploziv karburant-ajër (EKA apo FAX), e nganjëherë quhen edhe municione karburant-ajër, armë me nxehtësi dhe shtypje apo bomba vakumike.

13. “Armët me tojë apo tetivë” janë harqet dhe mekanizmat e tjerë që funksionojnë nën shtypjen e tojës apo tetivës së shtrënguar, të cilat gjuajnë me shigjetë apo predhë tjetër.

14. “Armë e ftohtë” është cilido mjet që mund të përdoret për sulm apo për shkakim të lëndimeve trupore, duke përdorur forcë fizike nga sulmuesi, në rastet kur ato mbahen në mjedise publike. Konsiderohen “armë të ftohta” thikat me një teh dhe me dy tehe prerëse, bajonetat, shpatat dhe çdo mjet tjetër i ngjashëm, i përgatitur e i destinuar posaçërisht për sulm kundër personave ose për vetëmbrojtje.

15. “Armë me elektroshok” është arma që konsiderohet si armë paaftësuese, e cila përdoret për qetësimin e personit apo të shtazës përmes elektroshokut, që ka për qëllim pengimin e funksioneve të muskujve sipërfaqësorë. Ndër të tjera, janë “armë elektroshoku” armët dhe shkopinjët për paralizim të përkohshëm, që shkaktojnë shok elektrik përmes kontaktit të drejtpërdrejtë.

16. “Armë për qëllime industriale” është arma e prodhuar për alarmim, sinjalizim, shpëtim të jetës, therje të kafshëve apo për peshkim me harpun, për qëllime industriale ose teknike, me kusht që ato të përdoren vetëm për qëllimin e sipërpërmendur.

17. “Armë zjarri për gjueti” është arma e zjarrit e prodhuar apo kryesisht e përdorur për

gjueti të shtazëve për qëllime të të ushqyerit ose për sport, të cilat dallohen nga ato të kategorisë “A” apo nga armët që kryesisht përdoren për qëllime luftarake dhe që u përkasin kategorive “B” e “C”, përmes të cilave gjuetia lejohet në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme për gjuetinë.

18. “Armë zjarri sportive” është arma e zjarrit e prodhuar apo kryesisht e përdorur për ngjarje specifike dhe të paracaktuara sportive, armë zjarri që u përket kategorive “B”, “C” dhe “D”, që është në përputhje me dispozitat e veçanta që rregullojnë sportet e qitjes.

19. “Armë dekorative” nënkupton gjësend të prodhuar për qëllime dekorative, i cili nuk mund të përdoret si armë zjarri.

20. “Imitim i armës” është mjete, dukja e jashtme e të cilit ngjason me atë të armës, por që nuk mund të përdoret si armë zjarri apo nuk mund të prodhohet pa ndonjë mekanizëm të nevojshëm të qitjes e as që mund të përshtatet për qitje.

21. “Armë antike e zjarrit” është çdo armë e zjarrit që ndizet me shkrepëse, gur stralli apo me kapsollë ose me sistem të ngjashëm të ndezjes, e prodhuar para vitit 1899.

22. “Riprodhim i armës së zjarrit antike” është kopja e armës së zjarrit antike, mekanizmi shkrepës i së cilës është modifikuar përmes teknologjisë moderne.

23. “Pjesa kryesore e armës së zjarrit” është çdo element që është i projektuar në mënyrë specifike për armë të zjarrit dhe është thelbësor për funksionimin e saj, duke përfshirë, mes të tjerash: mekanizmin e këmbëzës së shkrepjes, gjilpërën goditëse, tytën me folenë e fishekut, kutinë e tytës, shulin me shtratin e shulit dhe pjesët përbërëse të tyre, sustën paraprurëse, pistonin e gazrave me sustën, siguresën dhe çdo pajisje e projektuar ose e përshtatur për të zvogëluar zhurmën e shkaktuar nga e shtëna me armë zjarri.

24. “Pajisje e posaçme për armë të zjarrit” është çdo mekanizëm që është i prodhuar dhe i dedikuar për përmirësimin e konstruksionit (shabllonit) bazë të armës së zjarrit, e cila, përmes aplikimit të saj, e rrit performancën dhe cilësinë e përdorimit të armës së zjarrit, përveç shënjestrës optike.

25. “Zbutësi i zhurmës” është pajisje që i bashkëngjitet tytës apo është pjesë e saj, me qëllim zvogëlimin e zhurmës dhe të flakës së krijuar nga qitja me armë zjarri.

26. “Shënjestra optike” është pajisje e posaçme për armë të zjarrit apo për armë të ftohta, që është e prodhuar si mjet ndihmës për shënjestrim apo mjet optik dhe që përdoret si ndihmë në caktimin e shënjestrës, duke e udhëhequr syrin dhe duke e përshtatur atë me armën apo me mjetin tjetër që duhet të drejtohet kah shënjestra. Shënjestra optike mund të përdoret për të përmirësuar armët e gjuetisë dhe ato sportive, të cilat përdoren për qëllime përkatëse të autorizuar, sipas autorizimeve nga organi përgjegjës, siç është shoqata e qitjes apo ajo e gjuetisë.

27. “Përshtatësit e kalibrit apo të tytës” janë pajisje të dedikuara për përdorim në gjueti dhe në qitje sportive, të cilat futen në tytë, me qëllim ndryshimin e dimensionit apo kalibrit të tytës dhe armës së zjarrit, përmes të cilave arma e zjarrit nuk e ndryshon kategorinë ekzistuese, në përputhje me këtë ligj.

28. “Arma e zjarrit që në mënyrë të përhershme është paaftësuar për përdorim (çaktivizuar)” janë armët e zjarrit të kategorive “B”, “C” dhe “D”, të cilat në mënyrë të përhershme janë bërë jofunksionale, përmes zbatimit të procedurës teknike në njërin nga pjesët kryesore të tyre dhe që janë certifikuar nga organi përgjegjës.

29. “Municion” është cikli i plotë ose komponentët e tij, përfshirë gëzhojën, kapsollën, barutin shtytës, plumbin ose predhën, që përdoren në një armë zjarri. Përkufizimi përfshin, por, duke marrë parasysh avancimet teknologjike, nuk është i kufizuar në:

a) Fisheku paraqet kombinimin në një njësi të vetme të gëzhojës, plumbit, mbushësit dhe ndezësit (kapsollës).

b) Plumbi është element i fishekut me gëzhojë, në armët e kalibrit të vogël.



c) Numri i madh i predhave të vogla (saçme), qëllimi i të cilave është shkrepja e përnjëhershme me një të shtënë të vetme. Armët që mund të mbahen me dorë, të prodhuara për këtë lloj të municionit, janë kryesisht të njohura si pushkë gjuetie.

ç) Plumbi i pushkës me ajër është predhë josferike, e paracaktuar për qitje nga pushka me ajër.

30. “Municioni me plumb blindshpues” është municioni i paracaktuar për përdorim ushtarak, plumbi i të cilit është i destinuar për të depërtuar në metal apo në blind.

31. “Municioni me predhë eksplozive” është municioni i paracaktuar vetëm për përdorim ushtarak, plumbi i të cilit përmban mbushje që eksplodon në momentin e goditjes apo që ka fitil të përcaktuar me kohë ose të vonuar, që rezulton me eksplodimin e municionit në kohën e paracaktuar.

32. “Municioni me plumba të ndezshëm” nënkupton, por nuk kufizohet në municionin e paracaktuar për përdorim ushtarak, plumbat e të cilit përmbajnë përzierje kimike të ndezshme, dhe mund të përfshijë municion që përmban metal të përzier ekzotermik dhe piroforik në formë të predhës, i paracaktuar për qëllim të hedhjes apo përhapjes së flakës për të nxitur hedhësin e flakës.

33. “Municioni gjurmëlënës” është municioni që është i destinuar për të lënë gjurmë tymi apo ndriçimi gjatë trajektorës për në takim me objektivin. Ky lloj municioni përdoret për të ndihmuar në ndryshimin e trajektorës për gjetjen e kontaktit të plumbit me objektivin.

34. “Municioni për armët për përdorim të agjentëve kimikë” është municioni që përmban mbushje kimike në plumb, që ndikon në shëndetin e njerëzve apo të kafshëve.

35. “Armët e kombinuara të zjarrit” konsiderohen armët e zjarrit me më shumë tyta. Kombinimi i tytave mund të përbëhet prej tyta të vjaskuara dhe të pavjaskuara me kalibër të ndryshëm.

36. “Organi përgjegjës”, në përputhje me dispozitat e këtij ligji për autoritetin shtetëror që miraton licencën e veprimtarisë, nënkupton organin përkatës, sipas përcaktimit me akt nënligjor të organit brenda institucionit, në përbërje ose varësi të Ministrisë së Mbrojtjes apo të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

KREU II

KUPTIMI DHE KATEGORIZIMI I ARMËVE

Neni 3

Kuptimi i armës dhe llojet

1. Armë, sipas këtij ligji, konsiderohet, por nuk kufizohet në çdo mjet ose vegël e punuar me qëllim që, nën presionin e gazrave, të cilat shkaktohen gjatë djegies së materialeve shpërthyes, elektricitetit, gazrave nën presion ose energjisë tjetër potenciale, të hedhë predha në formë plumbi, grumbulli prej saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose përbërësish të tjerë, që është e përcaktuar ose është përdorur për të shkaktuar dëm trupor, fizik e psikologjik, si dhe çdo mjet tjetër, qëllimi i të cilit është të bëjë sulm fizik ndaj integritetit të njerëzve ose pronës.

2. Sipas këtij ligji, armë konsiderohen:

- a) armët e zjarrit;
- b) armët e koleksionit;
- c) armët pneumatike (ajrore);
- ç) armët për përhapjen e gazrave irrituese;
- d) armët shpërthyes;
- dh) armët me hark, tojë apo mekanizëm elastik;
- e) armët e ftohta;
- ë) armët për sinjalizim me dritë dhe me zë;
- f) paralizuesit elektrikë;

- g) armët me drejtim energjetik;
- gj) mjetet speciale;
- h) çdo mjet tjetër i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Si armë konsiderohen, po ashtu, municioni dhe pjesët kryesore përbërëse të armës, nëse në këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Ky kuptim i zgjeruar i termit “armë” vlen, ndër të tjera, edhe për licencat dhe autorizimet e parashikuara në këtë ligj.

4. Si armë, sipas këtij ligji, nuk konsiderohen:

- a) armët për qëllime industriale;
- b) armët dekorative;
- c) imitimet e armëve;
- ç) armët, të cilat janë bërë të papërdorshme në mënyrë të përhershme (të çaktivizuara), përmes zbatimit të procedurave teknike, të cilat janë të garantuara apo të njohura nga organi përgjegjës;
- d) harpunët për peshkim nën ujë;
- dh) çdo mjet tjetër i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Kategorizimi i armëve

1. Armët, sipas këtij ligji, kategorizohen si më poshtë:

1.1. Armët e kategorisë “A” janë:

- a) predhat ushtarake plasëse dhe sistemet për lëshim (A1);
 - b) armët e zjarrit automatike (A2);
 - c) armët e zjarrit të kamufluara në formë të një mjete tjetër (A3);
 - ç) municioni me shkallë të lartë depërtuese, municioni me predha shpërthyes, municioni me predha ndezëse, si dhe predhat për municion të tillë (A4);
 - d) municioni për pistoleta dhe revolver me predhë shpërndarëse dhe hapëse, si dhe predhat për municion të tillë, përveç në rastet e armëve për gjueti apo ato sportive të personave që kanë të drejtë t’i përdorin ato (A5);
 - dh) armët e zjarrit me zbutës zhurmash të montuar (A6);
 - e) armët e zjarrit me tytë të vjaskuar, me kalibër mbi 12,7 mm (A7);
 - ë) armët e zjarrit të gjata gjysmautomatike për përdorim civil, që duken si armë zjarri automatike (A8);
 - f) mjetet plasëse dhe pjesët e tyre (A9);
 - g) armët me gaz dhe municioni i tyre (A10);
 - gj) pajisja e veçantë për armë zjarri (A11);
 - h) paralizuesit elektrikë (A12);
 - i) municioni gjurmëlënës (A13);
 - j) municioni me veprim të dyfishtë (A14);
 - k) municioni me kalibër 5,7 x 28 mm SS190 (A15);
 - l) armët e drejtuara me energji (A16);
 - ll) armët e zjarrit me vjaska poligonale (A17);
 - m) armë të tjera që plotësojnë kriteret e neneve 2 dhe 3 të këtij ligji, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
- 1.2. Armët e kategorisë “B” janë:
- a) armët e shkurtra të zjarrit gjysmautomatike apo vetërimbushëse (B1);
 - b) armët e zjarrit të shkurtra për një qitje, me ndezje qendrore (B2);
 - c) armët me ndezje anësore të shkurtra për një qitje, me gjatësi të përgjithshme më të vogël se 28 cm (B3);



ç) armët e zjarrit të gjata gjysmautomatike, me gushë ose fole për fishekë, që mund të mbajnë më tepër se tre fishekë (B4);

d) armët e zjarrit të gjata gjysmautomatike, me gushë ose fole për fishekë, që mund të pranojnë deri në tre fishekë. Kur mbushësi i tyre ndërrohet, këto armë mund të konvertohen, me ndihmën e një mjeti të zakonshëm, dhe të pranojnë më tepër se tre fishekë (B5);

dh) armët e zjarrit të gjata gjysmautomatike ose me përsëritje, me tytë të pavjaskuar, të gjatë deri në 60 cm (B6);

e) armët e zjarrit pneumatike, me energji të predhës mbi 7,5 J dhe kalibër mbi 4,5 mm (B7);

ë) armë të tjera që plotësojnë kriteret e neneve 2 dhe 3 të këtij ligji, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

1.3. Armët e kategorisë “C” janë:

a) armë zjarri e gjatë me përsëritje, që nuk është përfshirë në shkronjën “dh” të nënpikës 1.2 të kategorisë “B” (C1);

b) armë zjarri e gjatë me një gjuajtje me tytë të vjaskuar (C2);

c) armë zjarri e gjatë gjysmautomatike, që nuk është përfshirë në shkronjat “ç” e “dh” të kategorisë “B” (C3);

ç) armë e shkurtër zjarri me një qitje me goditje anësore, gjatësia e përgjithshme e së cilës nuk është më e vogël se 28 cm (C4);

d) armë zjarri me një qitje, e gjatë, me tytë të pavjaskuar (C5);

dh) armët pneumatike me energji të predhës deri në 7,5 J dhe kalibër deri 4,5 mm (C6);

e) armët e zjarrit për sinjalizim me dritë dhe me zë (C7);

ë) adaptues (C8);

f) armë të tjera që plotësojnë kriteret e neneve 2 dhe 3 të këtij ligji, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

1.4. Armët e kategorisë “D” janë:

a) armët e zjarrit antike (D1);

b) armët me hark apo tojë (D2);

c) armët e ftohta (D3);

ç) armë të tjera që plotësojnë kriteret e neneve 2 dhe 3 të këtij ligji, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Armët e zjarrit të kombinuara janë të klasifikuara/të grupuara në kategorinë e armëve të zjarrit me tytë të vjaskuar ose kalibrit më të madh me tytë të pavjaskuar, në rast se nuk ka tytë të vjaskuar.

3. Përjashtimisht nga nënpika 1.1 e pikës 1 të këtij neni, si armë zjarri të ndaluara nuk konsiderohen armët e zjarrit të gjuetisë dhe ato sportive të pajisura me shënjestër optike.

Neni 5

Moscenimi i legjislacionit për armët ushtarake

Kategorizimi i armëve, sipas nenit 4 të këtij ligji, bëhet për qëllimet e këtij ligji dhe nuk cenon parashikimet e legjislacionit në fuqi për armët dhe pajisjet ushtarake.

Neni 6

Regjimi juridik për kategoritë e armëve

Për armët e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji ka regjim të veçantë juridik, duke respektuar përfshirjen në kategoritë e ndryshme si më poshtë:

a) Në kategorinë “A” përfshihen armë, të cilat nuk lejohen të përdoren dhe për të cilat nuk lëshohet autorizim.

b) Në kategorinë “B” përfshihen armë, për mbajtjen e të cilave lëshohet autorizim në favor të personit që ka të drejtën e armës, sipas dispozitave të këtij ligji.

c) Në kategorinë “C” përfshihen armë me cilësi teknike më të kufizuara, për mbajtjen e të cilave është e nevojshme pajisja me autorizim.

ç) Në kategorinë “D” përfshihen armë, për të cilat nuk lëshohet autorizim dhe subjekti përkatës është i detyruar të njoftojë organin përgjegjës të Policisë së Shtetit, duke qenë i lirë t'i marrë ato në posedim pas kohës së llogaritur për mbërritjen e njoftimit në organin përgjegjës.

KREU III VEPRIMTARITË E LEJUARA ME ARMËT

Neni 7

Pronësia dhe veprimet juridike në lidhje me armët

1. Armët e gjahut dhe ato sportive, si dhe armët e koleksionit mund të jenë në pronësi private apo shtetërore. Armët e tjera, që janë objekt i këtij ligji, mund të jenë vetëm në pronësi shtetërore.

2. Veprimet juridike për kalimin e pronësisë ose të të drejtave të tjera mbi armët kryhen në përputhje me kushtet e kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave të dalë në zbatim të tij. Për sa nuk parashikohet në këto akte, zbatohen dispozitat e Kodit Civil.

Neni 8

Prodhimi, riparimi dhe çaktivizimi

1. Licenca për prodhimin, riparimin dhe çaktivizimin e armëve, pjesëve të tyre dhe municioneve përkatëse lëshohet nga Ministria e Mbrojtjes, pasi të jetë marrë mendimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

2. Prodhimi, riparimi dhe çaktivizimi i armëve, pjesëve të tyre e municioneve përkatëse lejohen të kryhen nga subjektet shtetërore dhe private. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre licencimeve.

3. Në licencën e lëshuar përcaktohen veprimtaritë dhe llojet e caktuara të armëve, për të cilat ajo miratohet.

4. Dokumentacioni, kushtet dhe kriteret për lëshimin e këtyre licencave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Veprimtaria e shitblerjes së armëve të gjahut dhe atyre sportive

1. Veprimtaritë e shitblerjes së armëve të gjahut dhe atyre sportive, pjesëve të tyre e municioneve përkatëse licencohen, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, nga struktura përkatëse në përbërje ose varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Miratimi në heshtje nuk zbatohet në rastin e këtyre licencimeve.

2. Në licencën e lëshuar përcaktohen veprimtaritë dhe llojet e caktuara të armëve, për të cilat ajo miratohet.

3. Veprimtaritë e shitblerjes, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, përfshijnë tregtimin e brendshëm, importin dhe eksportin.

4. Dokumentacioni, kushtet dhe kriteret për lëshimin e këtyre licencave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 10

Autorizimi për tjetërsim në kushtet e përdorimit vetjak

1. Veprimet për tjetërsimin ose transferimin e të drejtave të tjera, mbi armët e gjahut dhe ato sportive, të kryera brenda vendit, ose me origjinë importi apo destinacion importi, kur motivohen nga nevoja për përdorim e vetë subjektit, nuk ushtrohen mbi bazën e një licence. Me rastin e çdo veprimi të tillë juridik, organi përgjegjës i Policisë së Shtetit lëshon autorizim të veçantë në favor të personit fizik ose juridik.

2. Personat që fitojnë dhe ata që humbasin të drejtën e përdorimit ose një të drejtë tjetër më të lartë, mbi armët, në kushtet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, brenda një afati dhjetëditor nga humbja apo vendosja në mënyrë faktike në posedim mbi armën, njoftojnë organin vendor përgjegjës të Policisë së Shtetit, për të kryer regjistrimin e armës.

Neni 11

Futja dhe nxjerrja nga vendi e armëve të gjuetisë e atyre sportive

1. Organi përgjegjës i Policisë së Shtetit miraton autorizimin e veçantë, në favor të personave fizikë e juridikë, për futjen dhe nxjerrjen nga territori shtetëror të armëve të gjuetisë e atyre sportive, për nevoja të vetë personit, në kuadër të pjesëmarrjes në veprimtari që zhvillohen brenda ose jashtë vendit.

2. Shtetasit e huaj që marrin pjesë në veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni pajisen me autorizim të përkohshëm për mbajtjen e armës, në kushte lehtësuese, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Licenca për transportin e armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre

1. Licenca për transportin e armëve dhe municionit, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij ligji, lëshohet nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit në favor të personave fizikë apo juridikë, të cilët e kryejnë transportin e armëve në kuadër të veprimtarive të tyre tregtare, të ndryshme nga transporti e të licencuara sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Për veprimet juridike të kryera me armët, që motivohen nga nevoja për përdorimin e vetë subjektit, sipas nenit 10 të këtij ligji, autorizimi nënkupton edhe autorizimin për transportin e armës.

3. Autorizimi i lëshuar në favor të personave fizikë ose juridikë, në kuadër të mbajtjes së armës, nënkupton dhe të drejtën për transportin e saj.

Neni 13

Licenca për poligon civil qitjeje

Çdo subjekt që kërkon të administrojë një poligon civil qitjeje, të luajtshëm ose të paluajtshëm, të përdorur vetëm ose jo vetëm për qëllime rekreative, sportive ose të praktikës me shënjestër, duhet të aplikojë për licencë në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit.

Neni 14

Kushtet e përgjithshme të licencimit

1. Kushtet e përgjithshme të licencimit, për licencat e parashikuara në nenet 8, 9, 12, 13 dhe 23 të këtij ligji, janë këto:

a) subjekti të jetë regjistruar si subjekt tregtar dhe të ketë zyrën qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) subjekti të ketë përcaktuar drejtuesin administrativo-teknik.

2. Licenca jepet, me të drejtë ripërtëritjeje, në afatin e vlefshmërisë të caktuar, sipas pikës 4 të këtij neni.

3. Drejtuesi administrativo-teknik që do të ushtrojë këtë veprimtari duhet të plotësojë kushtet e parashikuara në nenin 22 të këtij ligji. Drejtuesi administrativo-teknik pajis me dëshmi aftësi personelin.

4. Çështjet e lidhura me përcaktimin e kushteve të posaçme të licencimit, rregullave të hollësishme për ushtrimin e veprimtarive të licencuara me armët, administrimin dhe ruajtjen e tyre, dokumentacionin që duhet të paraqitet nga subjekti, procedurat e shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, procedurat për dhënien, revokimin dhe afatin e vlefshmërisë së licencës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15

Detyrimet e subjektit të licencuar

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, subjekti i licencuar duhet të përmbushë këto detyrime:

a) të paguajë detyrimet financiare ndaj organeve shtetërore në afatin e përcaktuar, sipas legjislacionit në fuqi;

b) të mos e përdorë aktivitetin, për të cilin është licencuar, për të kryer, lehtësuar apo fshehur një veprimtari të kundërligjshme;

c) të fillojë veprimtarinë brenda 180 ditëve nga hyrja në fuqi e licencës;

ç) të mos transferojë armë dhe municione te subjekte, të cilat nuk janë të pajisura me autorizim/licencë përkatëse nga organi përgjegjës;

d) të raportojë në organin përgjegjës për aktivitetin mujor që kryen brenda datës 10 të muajit pasardhës;

dh) të mbajë evidenca të plota për veprimtarinë që kryen, me të dhëna për personat, armët dhe municionet. Për këto regjistrime duhet të jetë në çdo moment i mundshëm inspektimi nga organi përgjegjës. Format i regjistrit miratohet me urdhër të Ministrit të Brendshëm;

e) të marrë masat e nevojshme për sigurimin teknik të armëve dhe municioneve, me qëllim parandalimin e aksidenteve, ngjarjeve të mundshme gjatë prodhimit, lëvizjes, administrimit, ruajtjes e shitblerjes së tyre. Masat e nevojshme për këtë qëllim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

ë) të mos e transferojë veprimtarinë, për të cilën është lëshuar licenca, te një subjekt tjetër;

f) të kujdeset për certifikimin nga organi përgjegjës të personelit që punëson për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar. Rregullat për certifikimin e personelit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

g) të përmbushë brenda afateve të caktuara detyrat e lëna me shkrim, sipas ligjit, nga organi përgjegjës.

Neni 16

Inspektimi nga organi përgjegjës

Ushtrimi nga personat fizikë dhe juridikë i veprimtarisë së licencuar/autorizuar i nënshtrohet inspektimit të rregullt nga organi përgjegjës për lëshimin e titullit, gjatë të cilit zbatohen dispozitat e ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe dispozitat e tjera të zbatueshme në fuqi.



KREU IV E DREJTA DHE KUSHTET E MBAJTJES SË ARMËS

Neni 17

Autorizimi për mbajtje arme

Kanë të drejtë të pajisen me autorizim për mbajtje arme zjarri nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit:

a) deputetët, anëtarët e Këshillit të Ministrave, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, anëtarët e Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, zëvendësministrat, prefektët;

b) kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, gjyqtarët, prokurorët, punonjësit e Policisë Gjqësore dhe ata, të cilëve, me ligj, u njihen funksionet e Policisë Gjqësore;

c) punonjësit e shoqërive të ruajtjes dhe të sigurisë fizike;

ç) punonjësit e ngarkuar për sigurinë e brendshme të objekteve të Bankës së Shqipërisë, ku administrohen vlera monetare;

d) punonjësit e forcës së sigurisë portuale në varësi të Autoritetit Portual;

dh) drejtuesi i automjetit, i cili, sipas ligjit nr. 10 160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë”, të ndryshuar, është vënë në dispozicion të secilit prej subjekteve të përmendura në këtë nen. Të drejtën e pajisjes e gëzon edhe drejtuesi i automjetit të vënë në dispozicion të funksionarëve të pushtetit gjyqësor, të përmendur në shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni.

e) subjekte të tjera, për të cilat e drejta e mbajtjes së armës parashikohet nga një dispozitë ligjore.

Neni 18

Pajisja me armë zjarri

1. Pajisja me armë zjarri e subjekteve, për të cilat lëshohet autorizim, sipas nenit 17 të këtij ligji, bëhet nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit. Shoqëritë e ruajtjes dhe sigurisë fizike, nëse pajisja me armë zjarri nga Policia e Shtetit nuk është e mundur, marrin masa për ta prokuruar armatimin nga shoqëritë e licencuara, sipas dispozitave në fuqi për tregtimin e armëve të zjarrit. Për çdo veprim të tillë lëshohet autorizimi përkatës nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit dhe, me rastin e mbërritjes së armatimit, bëhet kontabilizimi i tij pranë organit përgjegjës.

2. Në çdo rast dhe pavarësisht nga mënyra e pajisjes me armë të subjektit përkatës, organi përgjegjës i Policisë së Shtetit mbikëqyr dhe mban evidenca për procesin e inventarizimit dhe shpërndarjes së armatimit. Kategoritë e punonjësve që pajisen me armë zjarri dhe lloji i armatimit, kur nuk përcaktohen në legjislacionin përkatës, përcaktohen në bashkërendim ndërmjet institucionit përkatës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Neni 19

Mbjajtja e armës nga autoritetet e huaja

1. Të drejtën për t’u pajisur me autorizim për mbajtje arme, mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe parimit të reciprocitetit, e kanë edhe personat e autoritetet e huaja si më poshtë:

a) diplomatë të huaj, nëpunës të konsullatave dhe persona të huaj të barazuar në funksion me ta;

b) punonjës të misioneve ushtarake të huaja të vendosura në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) persona të cilët kanë për detyrë mbrojtjen e mjeteve të transportit ajror dhe të anijeve detare;

ç) misionet e ndryshme policore e ushtarake, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, për sigurimin personal ose të objekteve (rezidencave) të tyre me roje policore të brendshme që janë sjellë nga vetë ata;

d) shtetasit e huaj që vijnë në Republikën e Shqipërisë për veprimtari sportive të qitjes dhe të gjuetisë;

dh) subjekte të tjera, për të cilat e drejta e mbajtjes së armës parashikohet nga një marrëveshje ndërkombëtare ose dispozitë ligjore.

2. Autorizimi për personat e përmendur në pikën 1 të këtij neni, lëshohet për një afat të kufizuar dhe përmban të dhënat përkatëse të personit dhe të armës për të cilën lëshohet autorizimi.

3. Për futjen dhe nxjerrjen e armëve nga territori shtetëror, si dhe transportin brenda vendit, në favor të subjekteve të përmendura në pikën 1 të këtij neni, lëshohet autorizim, i cili mund të marrë formën e një akti të vetëm administrativ, të lëshuar së bashku me autorizimin e mbajtjes së armës.

Neni 20

Autorizimi për mbajtje arme gjahu, sportive dhe armët e tjera

Autorizimi për mbajtje arme gjahu ose sportive, si dhe për armët e tjera, të ndryshme nga armët e zjarrit, që janë objekt i parashikimeve të këtij ligji e për të cilat kërkohet autorizim, jepet nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit në favor të subjekteve:

a) për të cilat e drejta e mbajtjes së armës parashikohet nga dispozitat ligjore të zbatueshme për gjuetinë;

b) që ushtrojnë në mënyrë profesionale apo amatore veprimtari që përfshihen në sportin e qitjes ose të praktikës me shënjestër;

c) për të cilat e drejta e mbajtjes së armës parashikohet në dispozita ligjore.

Neni 21

Akti i vetëm administrativ

Autorizimet për të blerë dhe për të mbajtur armë, që përfshihen në kategorinë “B” dhe “C”, sipas nenit 4 të këtij ligji, mund të marrin formën e një akti të vetëm administrativ.

Neni 22

Kushte të përgjithshme për pajisjen me autorizim

1. Shtetasit që janë përfitues të autorizimeve, sipas parashikimeve të këtij ligji, duhet të plotësojnë këto kushte:

a) të kenë mbushur moshën 22 vjeç;

b) të jenë të aftë nga ana fizike e mendore;

c) të mos kenë qenë të dënuar më parë për vepra penale që përbëjnë krime;

ç) të zotërojnë dëshminë për kryerjen e kursit të aftësisimit teorik dhe praktik për përdorimin e armës;

d) të gëzojnë besueshmëri.

2. Parashikime të hollësishme për kushtet e pajisjes, për kushtet e tjera të nevojshme ose për përjashtimin nga zbatimi, në raste të veçanta, të kushteve të përgjithshme jepen me vendim të Këshillit të Ministrave.



Neni 23

Licenca për aftësimin e personave të autorizuar

Organi përgjegjës i Policisë së Shtetit licencon personat juridikë të interesuar për ushtrimin e veprimtarisë së aftësimit teorik e praktik të personave fizikë, kërkues të autorizimit për mbajtje arme.

Neni 24

Përgjegjësia për ruajtjen, përdorimin dhe raportimin

1. Personi që mban me autorizim armë të çdo lloji, mban përgjegjësi, sipas dispozitave të këtij ligji, në rast përdorimi të armës nga persona të tretë. Mbajtësi nuk përgjigjet nëse provon se ka treguar kujdesin e nevojshëm për ruajtjen e armës në mënyrë të sigurt, duke marrë masat e duhura për të shmangur kontaktin e personave të tretë me armën.

2. Ndalohet përdorimi i armës jashtë destinacionit të saj. Qitja me armë zjarri lejohet vetëm në poligonet ose në vendet e caktuara për këtë qëllim, me masa sigurie.

3. Mbajtësit me autorizim të armëve dhe municionit raportojnë çdo gjashtë muaj në organin përgjegjës për lëshimin e autorizimit, për gjendjen teknike të armës dhe rrethanat e tjera që shoqërojnë procesin e mbajtjes së saj. Në rast se ka episode të përdorimit të armës, sipas destinacionit të saj, raportimi i mësipërm kryhet në mënyrë periodike, por jo më shumë se tre muaj nga përdorimi.

Neni 25

Pushimi i së drejtës për mbajtje arme

1. Kur shtetasit që janë përfitues të autorizimeve, sipas neneve 17 e 20 të këtij ligji, largohen nga detyra ose kur nuk ekziston më rrethana tjetër, në bazë të së cilës u konsideruan përfitues, u pushon vetiu e drejta për mbajtjen e armës dhe detyrohen që, brenda tri ditëve, ta dorëzojnë atë në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit.

2. Organi i Policisë së Shtetit, i cili është vënë në ruajtje të armës, sipas pikës 1 të këtij neni, e mban armën:

a) deri në lëshimin sërish të autorizimit për zotëruesin e armës;

b) deri kur të vërtetohet transferimi, sipas ligjit, i armës te një person tjetër që zotëron autorizim.

Neni 26

Armët e koleksionit

1. Armët e koleksionit, në varësi të dispozitave ligjore në fuqi për trashëgiminë kulturore, mund të përbëjnë ose jo objekte të trashëgimisë kulturore materiale të luajtshme.

2. Armët e koleksionit ruhen në muze ose në mjediset e caktuara nga personat fizikë e juridikë, që janë zotërues të tyre, me të drejtën e municioneve mësimore të çaktivizuara.

3. Zotëruesit e armëve dhe muzetë publikë e privatë paraqesin, në mënyrë periodike, në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit, listën e armëve të koleksionit që janë në zotërim ose në ruajtje të tyre apo që synojnë t'i përfshijnë në koleksion në periudhën në vazhdim.

4. Për koleksionin e armëve, përfshirë edhe rastin e objekteve të trashëgimisë kulturore, që plotësojnë kriteret për t'u konsideruar si armë, në kuptim të këtij ligji, organi përgjegjës i Policisë së Shtetit lëshon autorizimin përkatës në favor të institucionit ose personit që kryen ruajtjen e tij.

5. Për armët e koleksionit, që përbëjnë objekte të trashëgimisë kulturore, administrimi i tyre respekton, gjithashtu, dispozitat ligjore në fuqi për trashëgiminë kulturore të luajtshme.

Neni 27

Mbledhja e të dhënave personale

1. Organet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji mund të mbledhin të dhëna personale nga institucionet dhe subjektet e tjera publike e private, në rastet kur administrimi i së dhënës përkatëse është i nevojshëm për qëllimet e lëshimit të licencave dhe autorizimeve të parashikuara në këtë ligj. Të njëjtat të dhëna mund të mblidhen edhe pa pëlqimin e subjektit të së dhënës, në rast shqyrtimi të rrethanave, me qëllim revokimin e licencës apo autorizimit.

2. Gjatë veprimtarisë së mbledhjes dhe trajtimit të të dhënave zbatohen dispozitat në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 28

Evidentimi i të dhënave për armët

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit zbaton dispozitat në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore, lidhur me të dhënat për armët, licencat, autorizimet, blerësit, zotëruesit dhe ish-zotëruesit e armëve.

2. Personat fizikë dhe juridikë, të licencuar dhe të autorizuar sipas dispozitave të këtij ligji, mbajnë evidenca të sakta e të hollësishme, në formë të shkruar dhe elektronike, për të gjitha veprimet e veçanta të kryera me armët. Format i regjistrit miratohet me urdhër të Ministrit të Brendshëm.

Neni 29

Detyrimet financiare

1. Aplikimi për lëshimin e licencave dhe autorizimeve, sipas dispozitave të veçanta të këtij ligji, kryhet kundrejt pagesës për shërbimin administrativ, e cila duhet të mbulojë vetëm koston dokumentare.

2. Në rast lëshimi të licencës apo autorizimit, subjekti përkatës paguan tarifën e licencimit/autorizimit në afatin e caktuar nga organi përgjegjës për lëshimin e titullit. Mospagimi i tarifës sjell revokimin e titullit, sipas dispozitave të neneve 30 e 31 të këtij ligji.

3. Masa, kriteret dhe procedura për detyrimet financiare, sipas këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V

MASAT SHTRËNGUESE

Neni 30

Pezullimi e revokimi i licencës

1. Pa cenuar zbatimin e procedurave paraprahe, të përcaktuara në pikat e tjera të këtij neni, pezullimi ose revokimi i licencës vendoset ndaj titullarit të saj në këto raste:

a) kur titullari humbet kushtet e licencimit, të parashikuara në nenin 14 të këtij ligji dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave të dalë në zbatim të tij;

b) kur konstatohet se titullari, në dokumentacionin e dorëzuar, ka paraqitur të dhëna të pasakta ose të rreme;



- c) me kërkesë të titullarit për të hequr dorë nga licenca;
 - ç) kur titullari nuk përmbush sipas ligjit detyrimin për pagimin e gjobës së vënë si masë administrative;
 - d) kur titullari nuk përmbush detyrimet e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji.
2. Përpara marrjes së vendimit të revokimit, organi përgjegjës, si rregull, urdhëron ripërmbushjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, brenda një afati të arsyeshëm, pa pezullim të titullit ose pezullimin e titullit për një afat të arsyeshëm, deri në zbatimin e urdhrit për ripërmbushjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve. Ky parashikim nuk zbatohet në rastet e parashikuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni, për të cilat revokimi i licencës bëhet automatikisht.
3. Urdhri i pezullimit revokohet nga organi përgjegjës, kur vlerësohet se titullari i ka plotësuar të gjitha urdhërimet, sipas rastit.
4. Si rregull, licenca revokohet:
- a) kur rrethanat janë të tilla që s’do të kishte kuptim ose mundësi për ripërmbushjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljes së detyrimeve nga titullari, brenda çdo afati të arsyeshëm pezullimi;
 - b) në rast moszbatimi të urdhërimeve brenda afateve të arsyeshme të pezullimit;
 - c) në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga titullari dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtrim të interesit publik, që garantohet nga titulli përkatës apo legjislacioni në fuqi.

Neni 31

Pezullimi e revokimi i autorizimit

1. Organet e Policisë së Shtetit kanë të drejtë të revokojnë autorizimin për mbajtjen e armës, kur mbajtësi i autorizuar shkel rregullat për mbajtjen e përdorimin e armës, kur paraqet rrezik se mund ta përdorë atë si mjet për kryerjen e një vepre penale, kur pushon së përmbushuri kushtet për pajisjen me autorizim, si dhe për rrethana të tjera që cenojnë të drejtën e titullarit për ta pasur në vazhdim këtë status.
2. Kur revokohet autorizimi për mbajtjen e armës, arma dorëzohet në organet e Policisë së Shtetit. Për armët e gjahut, ato sportive, si dhe armët e tjera që janë në pronësi të subjektit përkatës, organet e Policisë së Shtetit e mbajnë armën, sipas rastit:
- a) deri në kalimin e gjendjes së rrezikut që u bë shkak për revokimin e autorizimit për mbajtjen e armës;
 - b) deri në lëshimin sërish të autorizimit për zotëruesin e armës;
 - c) deri kur vërtetohet transferimi sipas ligjit i armës te një person tjetër që zotëron autorizim.
3. Revokimi i autorizimit mund të vendoset nga organi përgjegjës për miratimin e tij, sipas dispozitave të këtij ligji, edhe në rastin e autorizimeve të tjera të parashikuara në këtë ligj, për rrethana që cenojnë të drejtën e titullarit për ta pasur në vazhdim këtë status.
4. Në mënyrë të ngjashme me parashikimet e pikës 4 të nenit 30 të këtij ligji, përpara revokimit organi përgjegjës mund të shqyrtojë nëse është e mundur dhe e drejtë të procedohet më parë me pezullimin e titullit.

Neni 32

Kundërvajtjet administrative

1. Personat fizikë dhe juridikë që veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave në zbatim të tij, kur veprimet e tyre përkatëse nuk përbëjnë vepër penale, janë përgjegjës për kundërvajtje administrative.

2. Dënohet me gjobë prej 50 mijë deri në 200 mijë lekë personi fizik ose juridik, i cili tregton, furnizon, posedon, prodhon, riparon, çaktivizon, shkëmben, dorëzon ose kryen çdo veprim tjetër të lidhur me armë, kur veprimet e tij janë të ndaluara, jo të licencuara/autorizuara, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave të dalë në zbatim të tij.

Për shkeljet e përmendura në këtë pikë të nenit personi dënohet, gjithashtu, me masat plotësuese të konfiskimit të armës dhe të ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë përkatëse në afat nga dy deri në pesë vjet.

3. Dënohen me gjobë prej 30 mijë deri në 100 mijë lekë personi juridik dhe me gjobë 15 mijë deri 80 mijë lekë personi fizik, kur:

- a) e mban armën në kundërshtim me dispozitat në fuqi;
- b) në afatin e caktuar nuk parashtron kërkesën për regjistrimin e armës pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit;
- c) nuk paraqet armën e koleksionit për regjistrim pranë organit përgjegjës të Policisë së Shtetit;
- ç) shkel rregullat e caktuara për ruajtjen dhe evidentimin e armëve;
- d) shkel rregullat e caktuara në rast zhdukjeje, humbjeje, vjedhjeje të armës ose të dokumentit që njeh të drejta mbi të;
- dh) nuk aplikon për ripajisje me autorizim për mbajtje arme, në rast ndryshimi të vendbanimit, vendqëndrimit apo selisë;
- e) pas vdekjes së mbajtësit, anëtarët e familjes nuk dorëzojnë përkohësisht armën në organin vendor të Policisë së Shtetit;
- ë) nuk kryen apo kryen me mangësi mbajtjen e evidencës së armëve dhe të veprimeve të kryera me to;
- f) nuk vë në dispozicion të organit përgjegjës kërkues të dhënat përkatëse të nevojshme për lëshimin apo revokimin e licencës/autorizimit për personin subjekt i të dhënave.

Për shkeljet e përmendura në shkronjat “a”, “dh”, “e” të kësaj pike, personi dënohet, gjithashtu, me masën plotësuese të konfiskimit të armës.

4. Me gjobë nga 100 mijë deri në 200 mijë lekë dënohet personi juridik ose fizik, i cili:

- a) shkel rregullat e parashikuara për shitjen dhe shkëmbimin e armëve të zjarrit;
- b) e ruan armën në mënyrë që bie ndesh me dispozitat ligjore në fuqi;
- c) nuk fillon ushtrimin e veprimtarisë së licencuar në afatin e caktuar nga dispozitat ligjore në fuqi;
- ç) në veprimtaritë e riparimit e çaktivizimit të armëve vepron me armë të paevidentuara nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit ose, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, lejon nxjerrjen e armës nga vendi i punës përpara riparimit;
- d) pa lejen e organit përgjegjës kthen sërish në gjendje pune armën e çaktivizuar më parë ose shkel dispozitat e tjera ligjore në fuqi për trajtimin e armëve të çaktivizuara;
- dh) lëshon në qarkullim armë, të cilat nuk janë shënjuar, testuar në pajtim me dispozitat në fuqi;
- e) transporton armë pa leje ose në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për marrjen e masave të posaçme për siguri gjatë transportit;
- ë) gjatë transportit ose në çdo rast tjetër që i kërkohet nga organi shtetëror përgjegjës nuk paraqet dokumentet që vërtetojnë të drejta mbi armët.

Shkeljet e përmendura në këtë pikë dënohen, gjithashtu, me masat plotësuese të ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë përkatëse, në afat nga një deri në tre vjet, dhe të konfiskimit të armëve.

5. Me gjobë nga 50 mijë deri në 100 mijë lekë dënohet personi fizik ose juridik, i cili:

- a) shkel kushtet dhe kërkesat e zbatueshme për veprimet juridike në lidhje me armët;



b) nuk njofton, raporton apo aplikon pranë organit përgjegjës, sipas detyrimeve që rrjedhin nga rregullat në fuqi;

c) pengon ose nuk merr masat e nevojshme për të lejuar inspektimin e veprimtarisë që ushtron nga organi përgjegjës për licencimin/autorizimin e saj;

ç) shkel kushtet dhe kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar/autorizuar;

d) kryen shkelje të rregullave të caktuara për ushtrimin e veprimtarisë së aftësisimit teorik dhe praktik të personave fizikë, kërkues të autorizimit për mbajtje arme;

dh) nuk parashtron, në afatin e caktuar, kërkesë për regjistrimin e armës, për të cilën lëshohet autorizim për mbajtje arme;

e) shkel rregullat e caktuara në rast tregtimi të brendshëm ose nëpërmjet eksportit dhe importit të armëve që janë objekt i rregullimeve të këtij ligji;

ë) shkel rregullat e caktuara për mbajtjen dhe përdorimin e armëve nga anëtarët e shoqatave të gjutisë dhe të sportit të qitjes;

f) shkel rregullat e tjera të caktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, të dalë në zbatim të këtij ligji.

Për shkeljet e përmendura në këtë pikë, në përputhje me rrezikshmërinë e shkeljes, personi mund të dënohet, sipas rastit, edhe me masat plotësuese të ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë përkatëse në afat nga gjashtë muaj deri në dy vjet dhe të konfiskimit të armëve.

6. Kriteret dhe procedurat përkatëse për kundërvajtjet administrative, sipas këtij neni, janë ato të parashikuara në ligjin “Për kundërvajtjet administrative”.

KREU VI DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 33 Dispozitë kalimtare

1. Tetëmbëdhjetë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, lejet dhe aktet e tjera administrative që japin të drejta mbi armët, të lëshuara në bazë të ligjit nr. 7566, datë 25.5.1992 “Për armët”, dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, të lëshuara sipas kriterëve, formës e procedurave që nuk vijnë në pajtim me ligjin e ri “Për armët” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, humbasin fuqinë juridike me vendim të organit përgjegjës shtetëror. Përpara mbarimit të këtij afati, subjektet e interesuara për përtëritjen e akteve administrative të mëparshme aplikojnë për lëshimin e akteve të reja, sipas dispozitave të këtij ligji. Akti i ri që lëshohet i shtrin efektet kohore deri në mbarimin e afatit të aktit të mëparshëm dhe lëshohet pa zbatuar detyrimet financiare të përmendura në nenin 29 të këtij ligji.

2. Brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zotëruesit e armëve dhe muzetë publikë e privatë, që administrojnë armë të fituara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, paraqesin në organin përgjegjës të Policisë së Shtetit listën e armëve të koleksionit që janë në zotërim a në ruajtje të tyre ose që synojnë t’i përfshijnë në koleksion në periudhën në vazhdim.

Neni 34 Aktet nënligjore

Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcakton, me vendim, kriteret dhe procedura të mëtejshme në lidhje me:

a) kushtet e blerjes, mbajtjes, ruajtjes, prodhimit, riparimit, çaktivizimit, tregtimit, shitjes, gjurmimit, transportit, importit dhe eksportit të armëve për personat fizikë e juridikë;

- b) trajtimin e armëve sipas kategorive “A”, “B”, “C” e “D” dhe procedurat për armët e çdo kategorie;
- c) veprimet juridike për kalimin e pronësisë ose të të drejtave të tjera mbi armët;
- ç) veprimtaritë e prodhimit, riparimit, çaktivizimit, shitblerjes së armëve, si dhe veprimtaritë e tjera që i nënshtrohen licencimit/autorizimit;
- d) futjen dhe nxjerrjen nga territori shtetëror të armëve të gjuetisë dhe atyre sportive;
- dh) kushtet e pajisjes me autorizim dhe të mbajtjes së armës.

Neni 35
Shfuqizime

Ligji nr. 7566, datë 25.5.1992 “Për armët”, i ndryshuar, fjalia e tretë dhe e katërt e nenit 14 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës”, i ndryshuar, dhe çdo dispozitë ligjore e nënligjore që bie ndesh me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 36

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.3.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8070, datë 29.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

**LIGJ
Nr. 100/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 193, DATË 3.12.2009
“PËR MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET
E HUAJA NË ÇËSHTJET PENALE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 5 pika 3, fjalia e tretë ndryshohet si më poshtë:



“Përkthimi kryhet nga Ministria e Drejtësisë.”.

Neni 2

Në nenin 33 pika 2, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Aktet plotësuese të paraqitura nga shteti kërkues i përcillen organit të prokurorisë, të përkthyer, brenda 7 ditëve nga marrja e tyre.”.

Neni 3

Në nenin 72 pika 3, fjalia e tretë ndryshohet si më poshtë:

“Aktet plotësuese të paraqitura nga shteti kërkues i përcillen organit të prokurorisë, të përkthyer, brenda 7 ditëve nga marrja e tyre.”.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.3.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8071, datë 29.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 101/2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8653, DATË 31.7.2000 “PËR NDARJEN
ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81, 83 pika 1 dhe 108 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 2 të ligjit nr. 8653, 31.7.2000 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, në pasqyrën numër VII të qarkut të Korçës, emri i komunës “Liçenas” dhe emërtimi i qendrës “Liçenas” zëvendësohen me emërtimet “komuna Pustec” dhe “qendra Pustec”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.3.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8072, datë 29.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 3.4.2013
Doli nga shtypi më 3.4.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 32 lekë